



REPUBLIKA E SHQIPERISE
AGJENCIA PËR MBËSHTETJEN E SHOQËRISË CIVILE

KONTRATË

Nr. Ref. AI/ 018/ 2025

Nr. ____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2025

Sot, më datë _____. _____. 2025, lidhet kjo kontratë midis palëve të poshtë shënuara:

AGJENCIA PËR MBËSHTETJEN E SHOQËRISË CIVILE (AMSHC), ent publik qendror, buxhetor me **NIPT L01713451F** e krijuar në bazë të Ligjit Nr. 10 093, datë 09.03.2009 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Agjencisë për Mbështetjen e Shoqërisë Civile” dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 769 datë 15.07.2009 “Për Miratimin e Statutit të Agjencisë për Mbështetjen e Shoqërisë Civile”, e ndryshuar, me seli Rr. “Frosina Plaku” Nr.58, Kati 2, Godina e Observatorit, Tiranë, e përfaqësuar ligjërisht nga **Z.Andi KANANAJ**, në cilësinë e Drejtorit Ekzekutiv në cilësinë e “**AUTORITETIT FINANCUES**”.

Dhe

“**EMRI I OJF-SË/SHOQATËS**” _____ regjistruar si person juridik pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe me NIPT _____, sel _____ i dhe me përfaqësues ligjor, _____, me numër dokument identifikimi _____ në cilësinë e “**PËRFITUESIT**”.

NENI 1 BAZA LIGJORE

Kjo kontratë lidhet në bazë të Ligjit Nr.10 093 datë 09.03.2009 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Agjencisë për Mbështetjen e Shoqërisë Civile”; Ligjit Nr. 9917 datë 19.05.2008 “Për Parandalimin e Pastrimit të Parave dhe Financimit të Terrorizmit”, i ndryshuar, Ligjit Nr. 157/2013 “Për Masat kundër Financimit të Terrorizmit”, Ligji Nr.7850/1995 “Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, Neni 659 e në vijim, Ligji 44/2025 “Kodi i Proçedurave Administrative”, VKM-së Nr. 769 datë 15.07.2009 “Për Miratimin e Statutit të Agjencisë për Mbështetjen e Shoqërisë Civile”, e ndryshuar dhe aktet nënligjore në zbatim të saj dhe Vendimit të Bordit Mbikqyrës Nr.03 datë 07/07/2025.

NENI 2 OBJEKTI I KONTRATËS



REPUBLIKA E SHQIPERISE
AGJENCIA PËR MBËSHTETJEN E SHOQËRISË CIVILE

Objekti i kësaj Kontrate është financimi me Grant për Përfituesin nga ana e AMSHC-së, për zbatimin e Projektit me titull: “_____”.

NENI 3
PERIUDHA

Kjo Kontratë hyn në fuqi nga data e nënshkrimit të saj nga palët dhe përfundon me realizimin e të gjitha aktiviteteve të Projektit, brenda një afati ____ (_____) **mujor**, siç parashikohet në Formularin e Projekt-Propozimit të Plotë.

NENI 4
SHUMA E FINANCIMIT TË PROJEKTIT

AMSHC-ja do të mbështesë financiarisht zbatimin e projektit me _____ (_____) lekë.

NENI 5
MËNYRA E FINANCIMIT TË PROJEKTIT DHE TABELA E PAGESAVE

5.1 Autoriteti Financues do të kryejë pagesën për Përfituesin si më poshtë:

- Me nënshkrimin e kontratës do t'i kryejë pagesën paraprake prej 70 % të fondit të përfituar për Përfituesin.
- Pjesa prej 20 % e Grantit do të financohet pas miratimit të raportit afatmesëm, që përkon me ezaurimin e 70 % të periudhës së zbatimit të Projektit.
- Pjesa e mbetur prej 10 % do t'i kalojë Përfituesit pas miratimit të raportit final nga ana e AMSHC-së.

5.2 Tabela e pagesave do të kryhet si më poshtë:

Lloji	Shuma që do të paguhet (në Lekë)	Kushtet	Afati për pagesën
Pagesa paradhënie	(% e fondit të miratuar për financimin e mbulimit të shpenzimeve të pjesës së parë të Projektit).	Firmosja e Kontratës	15 ditë kalendarike pas nënshkrimit të Kontratës
Pagesa afatmesme	(% e fondit të miratuar për financimin e	Miratimi i raportit afatmesëm	7 ditë pas miratimit të raportit afatmesëm



REPUBLIKA E SHQIPERISE
AGJENCIA PËR MBËSHTETJEN E SHOQËRISË CIVILE

	mbulimit të shpenzimeve të pjesës së dytë të Projektit).		
Pagesa finale	(% e buxhetit vjetor).	Miratimi i raportit final	15 ditë kalendarike pas miratimit të raportit final

NENI 6
DETYRIMET E PËRFITUESIT

Përfituesi duhet që:

- Të kryejë aktivitetet e përshkruara në formularin e projekt-propozimit të plotë.
- Të shpenzojë fondet sipas zërave të buxhetit të miratuar, të paraqitur në formularin e projekt-propozimit të plotë.
- T'i kthejë AMSHC-së të gjitha fondet e pashpenzuara brenda 15 ditësh pas përfundimit të Projektit.
- T'i kthejë AMSHC-së brenda 7 ditëve pasi raporti final është shqyrtuar, të gjitha fondet të cilat janë përdorur për të mbuluar shpenzimet që AMSHC nuk i ka miratuar.
- Nëse Përfituese gjatë ekzekutimit të të drejtave dhe detyrimeve që burojnë nga kontrata për kohëzgjatjen e saj do të pësojë ndryshime të formës juridike, ndryshim të përfaqësuesit ligjor, ndryshim të adresës, etj duhet që brenda 10 ditëve nga ndryshimi i pësuar të njoftojë Autoritetin Kontraktues në rrugë zyrtare.

NENI 7
RAPORTIMI

7.1. Për Projektin që financohet, objekt i kësaj Kontrate, përfituesi duhet të dorëzojë Raportin Financiar dhe Raportin Përshkrues. Do të ketë një raport final i cili do të dorëzohet në fund të zbatimit të projektit por jo më vonë se 30 ditë kalendarike pas mbarimit të tij.

7.2 Përfituesi do të depozitojë pranë AMSHC-së në përfundim të muajit të _____ (që korrespondon me 70 % të kohës të zbatimit të projektit) Raportet përkatëse financiare narrative dhe të gjitha materialet shoqëruese të tyre. Në përfundim të zbatimit të projektit që korrespondon me muajin e _____ por jo më vonë se 30 ditë pas përfundimit do të depozitojë pranë AMSHC-së Raportet përkatëse financiare narrative dhe të gjitha materialet shoqëruese të tyre.

7.3 Raporti Financiar duhet të plotësohet sipas formatit të miratuar nga AMSHC- ja dhe nënshkruhet nga Përfaqësuesi Ligjor.

7.4 Raporti Përshkrues duhet të plotësohet sipas formatit të miratuar nga AMSHC dhe duhet të shoqërohet me jo më pak se 5 (pesë) kopje të çdo publikimi të realizuar në kuadër të aktiviteteve të



REPUBLIKA E SHQIPERISE
AGJENCIA PËR MBËSHTETJEN E SHOQËRISË CIVILE

projektit por edhe me fotografi apo filmime të aktiviteteve. Ky raport nënshkruhet nga Përfaqësuesi Ligjor.

7.5 Të gjitha raportet do të miratohen nga AMSHC-ja brenda 30 ditëve kalendarike, që nga dita e dorëzimit nga Përfituesi. Gjatë kësaj periudhe, AMSHC-ja do të ngrejë ekipin monitorues për verifikimin dhe kontrollin në vend të dy Raporteve të lart përmendura.

NENI 8
TË DHËNA MBI LLOGARINE BANKARE TË PËRFITUESIT

- a) Emri i Bankës së përfituesit:**
- b) Numri i Llogarisë:**
- c) Numri IBAN :**

NENI 9
PËRGJEGJËSIA E PËRFITUESIT

9.1 Përfituesi është subjekti përgjegjës për kryerjen me efektivitet të projektit sipas formularit të projekt-propozimit të plotë.

9.2 AMSHC-ja nuk mban asnjë përgjegjësi për dëmtime apo ankesa të shkaktuara nga dhe nëpërmjet projektit. Përfituesi mban të gjithë përgjegjësinë ndaj palëve të treta.

9.3 Përfituesi sipas rastit, duhet të dorëzojë aktin e vetëdeklarimit në formë zyrtare ku shprehet dhe deklaron se nuk lejon financimin e të njëjtit aktivitet/ iniciativë të objektit të kontratës me shuma të financuara nga subjekte të tjera veç AMSHC-së.

9.4 Përfituesi, pas njoftimit paraprak të Autoritetit Financues, do të duhet të marrë masa për prezencën e tij ose në emër të tij, në takimet/ konsultimet apo edhe eventet në të cilat AMSHC është organizatore apo kërkuuese të pranisë së Subjektit përfitues.

NENI 10
MONITORIMI/ KONTROLLI

10.1 Për çështjet që i takojnë monitorimit të objektit të kësaj Kontrate, palët duhet t'i përgjigjen kërkesës së njëra-tjetrës me shkrim brenda 10 ditëve kalendarike nga dorëzimi i saj.

10.2 Përfituesi duhet të ofrojë akses në çdo kohë për ekspertët monitorues të AMSHC-së, pas njoftimit paraprak të këtyre të fundit, për informacione dhe dokumente që lidhen me projektin dhe zbatimin e tij (duke përfshirë informacionin financiar). Kjo përfshin dhe nënkupton informacion mbi të gjithë projektin dhe jo vetëm mbi pjesën e financuar me fonde nga AMSHC-ja.

10.3 Përfituesi detyrohet të mbajë të gjithë dokumentacionin (duke përfshirë dokumentet financiare) lidhur me projektin të paktën 3 (tre) vjet pas përfundimit të tij. Gjithashtu është i detyruar të ofrojë akses në këto dokumente ndaj çdo auditi dhe monitorimi nga ekspertë që përfaqësojnë AMSHC-në si dhe nga Kontrolli i Lartë i Shtetit, që ka kompetencë të kontrollojë shpenzimin e fondeve publike.



REPUBLIKA E SHQIPERISE
AGJENCIA PËR MBËSHTETJEN E SHOQËRISË CIVILE

NENI 11
PUBLIKIMI

11.1 Përfituesi duhet të vendosë logon e AMSHC-së në të gjithë informacionin lidhur me aktivitetet që janë mundësuar me ndihmën financiare të AMSHC-së si dhe mbi të gjitha materialet, aktivitetet, faqet zyrtare të internetit dhe të tjera produkte të përgatitura në kuadër të projektit.

11.2 Në rastet e publikimit apo prezantimit publik të dokumenteve dhe materialeve të prodhuara në kuadër të projektit, përfituesi merr përsipër të vendosë pohimin e mëposhtëm: *“Ky publikim, është mundësuar me mbështetjen financiare të AMSHC-së. Përmbajtja e tij është përgjegjësi e autorit, opinioni i shprehur në të nuk është domosdoshmërisht opinion i AMSHC-së”*.

11.3 Me këtë kontratë, përfituesi detyrohet të lejojë AMSHC-në të publikojë emrin e përfituesit, adresën, qëllimin e projektit, aktivitetet si dhe fondin e marrë, në çdo mënyrë që Agjencia e konsideron të dobishme.

NENI 12
PRONËSIA E PRODUKTEVE TË PROJEKTIT

12.1 Të gjitha materialet e prodhuara në kuadër të projektit mbeten pronë e Përfituesit. AMSHC-ja gëzon të drejtën e përdorimit të tyre sipas nevojës, duke patur parasysh kufizimet që rrjedhin nga legjislacioni mbi të drejtën e pronësisë intelektuale.

12.2 Përfituesi duhet t'i dorëzojë AMSHC-së 5 (pesë) kopje për secilin publikim apo material të prodhuar në kuadër të projektit me përjashtim të fotove si pjesë e pasqyrimit të AMSHC-së si financues i projektit, që duhet të dorëzohen në format elektronik (CD/USB), listprezenca dhe/apo çdo material që prodhohet me zërat e financuara nga AMSHC.

NENI 13
NDRYSHIMET E KONTRATËS

13.1 Ndryshimet e rëndësishme në mënyrën/metodën dhe kohën e realizimit të aktiviteteve të projektit mund të ndodhin vetëm pas një miratimi paraprak nga AMSHC-ja.

13.2 Ndryshimet në zërat buxhetorë lejohen deri në një total prej 5% të fondit të financuar nga AMSHC-ja dhe mund të bëhen pa miratimin paraprak të Agjencisë. Përfituesi në këtë rast duhet të njoftojë me shkrim AMSHC-në në raportin pasues.

NENI 14
NDËRPRERJA E KONTRATËS

Kontrata mund të ndërpritet në rast:

- a. Përfituesi për shkaqe të pajustificuara, nuk realizon e aktivitetet në cilësinë dhe sasinë e parashikuar në projektin objekt të kësaj Kontrate.
- b. Përfaqësuesi ligjor i Përfituesit ka arsye të rënda shëndetësore/ vdekje.
- c. Përfituesi refuzon t'i vendosi në dispozicion AMSHC-së çdo material të kërkuar nga përfaqësuesit e saj që kanë të bëjnë me zbatimin e projekt-propozimit.



REPUBLIKA E SHQIPERISE
AGJENCIA PËR MBËSHTETJEN E SHOQËRISË CIVILE

- d. Përfituesi nuk merr pjesë në aktivitetet e njoftuara dhe organizuara nga AMSHC më shumë sesa dy herë pas komunikimeve zyrtare (e-mail, shkresë zyrtare, etj).
- e. Kontrolli i Shtetit ose autoritete të tjera që me ligj kanë të drejtë të kontrollojnë shpenzimet e fondeve buxhetore konstatojnë shkelje dhe kjo pranohet nga AMSHC-ja.
- f. Në rastet e Forcave Madhore, situatave të jashtëzakonshme, sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi.

NENI 15

PJESË PËRBËRSE TË KONTRATËS

Pjesë e pandashme e kësaj kontrate do të jenë dokumentat:

- 1- Formulari i aplikimit.
- 2- Raportet tip sipas të cilave do të bëhet raportimi nga Përfituesi, të përcaktuara nga AMSHC-së.
- 3- Vetdeklarim për mungesën e financimit të dyfishtë për të gjithë projekt-propozimin, apo zëra të dedikuar të tij.

NENI 16

SANKSIONET

16.1 Moszbatimi i detyrimeve për afatet e paraqitjes së raporteve financiare dhe përshkruese, sjell paralajmërimin e Përfituesit, ndërprerjen e financimit dhe përjashtimin nga financimi i projekteve për një periudhë 3 (tre) vjeçare.

16.2 Në rastin e mospërbushjes së aktiviteteve të projektit apo kryerjes së shpenzimeve që nuk kanë qenë të lejuara, pjesa respektive e buxhetit do t'i kthehet AMSHC-së.

16.3 Në rastin kur dëmtohet cilësia e aktiviteteve të projektit, Përfituesi detyrohet t'i kthejë AMSHC-së shumën/at e përdorur/a për financimin e këtyre aktiviteteve dhe/ose materiale publikuese.

NENI 17

KOMUNIKIMET

Palët do të komunikojnë në rrugë shkresore në adresat zyrtare respektive të tyre ose/dhe në formë elektronike në adresat e e-mail si më poshtë:

Për Autoritetin Kontraktues: info@amshc.gov.al

Për Përfituesin:

NENI 18

DISPOZITA TË FUNDIT



REPUBLIKA E SHQIPERISE
AGJENCIA PËR MBËSHTETJEN E SHOQËRISË CIVILE

18.1 Kjo Kontratë përbën marrëveshjen e plotë të palëve dhe përcakton në mënyrë ekskluzive afatet dhe kushtet lidhur me objektin e saj.

18.2 Përfituesi nuk lejohet të kryejë nënkontrakttime për realizimin e aktiviteteve me qëllim përmbushjen e objektit të kësaj Kontrate.

18.3 Për çështje që nuk parashikohen specifikisht në këtë Kontratë sikurse edhe mosmarrëveshjeve për çështje të financimit, raportimit apo monitorimit, palët do t'i referohen Ligjeve në fuqi dhe do t'i drejtohen Gjykatës kompetente.

18.4 Kjo Kontratë është hartuar dhe lidhur në 3 (tre) kopje origjinale në gjuhën shqipe me të njëjtën vlerë ligjore, nga të cilat 2 (dy) i mban AMSHC-ja dhe 1 (një) Përfituesi.

Pasi u lexua nga palët, Kontrata nënshkruhet me vullnetin e tyre të plotë dhe të lirë.

AUTORITETI FINANCUES

Drejtor Ekzekutiv i AMSHC-së

Z.

Firma _____

Vula

PËRFITUESI

Emri i OJF-së/Shoqatës

Z/Znj.

Firma _____

Vula